



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri:1

Tiranë – E mërkurë, 21 janar 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 8881, datë 8.1.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 3
Dekret i Presidentit nr. 8895, datë 13.1.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 3
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 1, datë 9.1.2015	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”..... 3
Urdhër i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 5.1.2015	Për delegim kompetencash..... 4

**DEKRET****Nr. 8881, datë 8.1.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës si dhe të nenit 9, pika 7 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare” të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Kulturës,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Nazmi Aziz Curri
2. Besime Nazif Curri (Statovci)
3. Kushtrim Nazmi Curri
4. Migjen Nazmi Curri
5. Arbëresha Nazmi Curri
6. Ezio Nereo Greggio
7. Elbasan Muamet Veza
8. Fadil Hazir Berisha
9. Zylfije Isak Ejupi Berisha (Ejupi)
10. Laureta Fadil Berisha
11. Erisa Fadil Berisha
12. Gani Selim Veselaj
13. Kreshnik Gani Veselaj
14. Valmir Gani Veselaj
15. Gentijana Gani Veselaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET**Nr. 8895, datë 13.1.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Kristaq Ksenofon Ikonomi
2. Laureta Vehap Qoku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM**Nr. 1, datë 9.1.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 23, DATË 9.12.2014 “PËR
MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE
TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2013, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, bëhet ky ndryshim:

“Në kreun 8 “Rimbursimi i kontributeve”, në pikën 8.1 germa f), shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani



URDHËR
Nr. 1, datë 5.1.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Gjykatën Kushtetuese, Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, z. Kujtim Osmani.

2. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor të Gjykatës Kushtetuese, do të ushtrohen për periudhën 5.1.2015, deri më 31.12.2015.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I GJYKATËS
KUSHTETUESE
Bashkim Dedja

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 42 lekë